



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01 Nr. _____/2015

Datë 04.12.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në baze të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 8,9,10 dhe 16.1 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe përfundimit nr. 06-54059-8/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve me dt. 14.08.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për subvencionimin e sektorit të blegtorisë me maqina mjelëse, e miraton këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbështetje financiare të sektorit të blegtorisë në Komunën e Gjakovës në vlerë prej 19,920.00€ për sigurimin dhe shpërndarjen e njëqind (100) maqinave mjelëse.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 19,920.00€ nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Bujqësi. Pylltari dhe Zhvillim Rural, me të cilat do të mundësohet realizimi i obligimeve të Komunës së Gjakovës sipas kontratës me operatorin ekonomik NPT “Star-Impiante profesionale” me seli në Prishtinë, me nr. kontrate 092 të datës 02.12.2015 dhe transferimi i vlerës së subvencioneve prej 19,920.00€ në xhirollogarinë e operatorit ekonomik me nr. 1701001011323184 në NLB Prishtina.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- NPT “Star-Impiante profesionale”, Prishtinë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari - Lila

